



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Laç, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Pastrimi, grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane dhe të ngurta, Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe e varrezave për Njësintë Administrative Milot dhe Fushë Kuqe”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
98341130-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 75,000,603 (shtatëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kurbin ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 ”Për prokurimin publik”, Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 1,500,012 (një milion e pesëqind mijë e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

a) Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se operatorit ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 9 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, nenin 41 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 15% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qene lloji i procedures eshte “Procedurë e hapur”, përcaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku percaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”*.

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se

operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025) të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: *"Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që verteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2026 (sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.10 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar,

neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 15 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (shërbimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 15 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për shërbime të ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 15 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë lejet dhe licencat përkatëse si më poshtë:

- a) Licencë me Kod: III.2.B, që të mbulojë aktivitetin: “*Grumbullim, transportim dhe ruajtje e mbetjeve jo të rrezikshme*”, lëshuar nga QKB, shoqëruar me Akt-miratimin përkatës që të përfshijë kodet për mbetjet urbane.

** Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj liçensat dhe lejet sipas shërbimit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në piken 2, te nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4, gërma “a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011”Per mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”. Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Licencë me Kod: III.2.B, kërkohet pasi objekti i kontratës përfshin, përveç pastrimit në terren, edhe hallkën e detyrueshme të menaxhimit të mbetjeve të mbledhura konkretisht: grumbullimin, ngarkimin, transportimin dhe dorëzimin e tyre në destinacionin e autorizuar (Landfill) dhe për të kryer një shërbim të tillë duhet të jesh i licensuar, për të garantuar kryerjen e shërbimit me cilësi deri në Landfill.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin** si më poshtë:

A. Duhet te disponojë **personelin kryesor** si më poshtë:

1(një) Drejtues Teknik / Përson përgjegjës që do të ndjekë shërbimin per te cilin duhet te paraqese:

- Diplomë
- Kontrate pune (e vlefshme)
- Si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

Shënim: Për plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (formulari të plotësohet me të dhënat e punonjësit si emer, mbiemer, profesioni).

B. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- **4 (katër) shofere**, të pajisur me Leje Drejtimi përkatëse për shofer kamioni, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për te paktën muajin e fundit ose të kontraktuar me kontratë pune të vlefshme (për të gjithë periudhën e kontratës).

Shënim: Për plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (formulari të plotësohet me të dhënat e punonjësit si emer, mbiemer).

C. Operatori ekonomik duhet të disponojë **15 (pesëmbëdhjetë) punëtorë**, për të cilët duhet të paraqesë kontatë pune të vlefshme si dhe duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajt e fundit.

Shënim: Për plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (formulari të plotësohet me të dhënat e punonjësit si emer, mbiemer).

Kjo kërkesë (pika 2.3.3), do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.10 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të ketë:

- 1(një) Drejtues Teknik / Përsone përgjegjës që do të ndjekë shërbimin, i cili referuar objektit të kontratës si dhe zërave të shërbimit që do realizohen është i domosdoshm që operatori ekonomik për kryerjen dhe mbarëvajtjen e shërbimeve të ketë pjesë të stafit 1(një) punonjes te tille për te kryer ndjekjen e gjithë procedures se pstrimit.
- 4 (katër) shofere, janë kërkuar sipas mjeteve që duhet të ketë në punë cdo ditë operatori ekonomik nga zberthimi i metodologjise/specifikimeve teknike bashkëngjitur DST, për realizimin e shërbimit me sukses.
- 15 (pesëmbëdhjetë) punonëtor (punëtorë të thjeshtë krahu): Janë kërkuar 15 punëtor sipas zbërthimit te preventivit/analizave në metodologjinë e hartuar nga komisioni i hartimit të specifikimeve teknike bashkëngjitur DST. Konkretisht këto punëtor do kryejnë zërat e punes (Punetor makine per grumbullim mbetjesh 6 persona, Puntore per fshirje rruge, sheshe dhe trotuare me krahe 5 persona, Punetor per mirembajtje te varrezave dhe hapesirave publike 4 persona).

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoe prej minimalisht **20 (njëzet) përsone**, vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen 3 muajt e fundit.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi, per periudhen 3 muajt e fundit.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.10 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do

të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur me sukses kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Totali i numrit të punonjësve është vendosur bazuar në metodologjinë e kryerjes së shërbimit hartuar nga komisioni dhe Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në volumet dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhën 3 muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është një prove bindëse për AK që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës duke marrë në konsideratë rëndësinë e këtij shërbimi për AK.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit, e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 20 persona është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimet si dhe VKM për kohën e punës në muaj për punonjës. Po t’i referohemi preventivit, VKM, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve për periudhën e kërkuar me sipër.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emërtimi i mjetit	Kapaciteti	Sasia	Pronësia
1	Makinë teknologjike transportuese pastrimi	8-12 ton	1	Në pronësi ose me qira
2	Makinë teknologjike transportuese pastrimi	5-8 ton	1	Në pronësi ose me qira
3	Makinë teknologjike transportuese pastrimi	3-5 ton	1	Në pronësi ose

				me qira
4	Makinë kamionçinë	3-5 ton	1	Në pronësi ose me qira
5	Fadrome me goma		1	Në pronësi ose me qira
6	Mjet për lagje rrugesh (Autobot Uji)	Mbi 10,000 litra	1	Në pronësi ose me qira
7	Mjet teknologjik, Zetor ose te ngjashem per prerje me krahe anash rrugeve te ferrave dhe barishteve degeve te ndryshme. Krahët te hapen deri ne 3 metra me mjetin prerës.	≥80 kuaj fuqi	1	Në pronësi ose me qira

- a) Për mjetet, kur janë në pronësi, duhet të shoqërohen me dokumentacionin si:- **Certifikatë pronësie/Leje qarkullimi; - Certifikatën e kontrollit teknik** (e vlefshme); **Siguracionin** (i vlefshëm); **Taksat Vjetore** (të vlefshme), si dhe **foto të mjetit** ku të jetë e dallueshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.

Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, por do të përdorën vetëm për realizimin e kësaj kontrate (për të gjithë periudhën e kryerjes së shërbimit) si dhe deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendodhjen e mjeteve.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.10 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesat e mesipërme janë vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Nenit 41, pika 4, germa ”ç” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qera janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar shërbimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së shërbimeve, referuar specifikimeve teknike, preventivit dhe analizave teknike bashkëlidhur. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët

ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, makineritë, për realizim me sukses të kontratës.

Mjetet e kërkuara janë vendosur sipas metodologjise së shërbimit të hartuar nga komisioni përkatës që ka kartuar specifikimeve teknike.

Mjetet e mesipërme janë kërkuar për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës.

Makinë teknologjike transportuese pastrimi me kapacitet 8-12 ton dhe 5-8 ton është kërkuar bazuar në llogaritjen e kostos pasi gjenerohen 11.7-12 ton në ditë mbetje (për grumbullimin e mbetjeve sipas metodologjise bashkëngjitur), ndërsa Makinë teknologjike transportuese pastrimi me kapacitet 3-5 ton është kërkuar në rast se kemi mbetje në sasi maksimale që kemi llogaritur si dhe në rast defektesh të ndonjë mjeti.

Makinë kamionçinë 3- 5 ton, e cila do të përdoret për mbetjet që do dalin nga fshirja e rrugëve, shesheve dhe hapsirave publike si dhe për transportin e kontenierëve.

Fadrome, e cila do të përdoret për heqjen e trungjeve të pemëve, shkurreve të thara si dhe në raste të tjera të nevojshme.

Mjet për lagje rrugësh (autobot uji) mbi 10.000 litra, i cili do të përdoret për lagjen e rrugëve si dhe për vadijtje në zonat e caktuara nga Autoriteti Kontraktor

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

- a) Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) **Përsëritjen e shërbimit që do të ndjekë shërbimin** për këtë objekt, për të cilin duhet të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet e përditshme në terren (për të gjithë periudhën e kontratës), i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.
- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë (nga Administratori i shoqërisë), i cili deklaron se stafi i punonjësve prej 20 persona (pika 2.3.3) që do të paraqesë/deklarojë për kryerjen e këtij shërbimi objekt kontrate nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet e përditshme në terren (për të gjithë periudhën e kontratës) vetëm për realizimin e këtij objekti.
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë (nga Administratori i shoqërisë), ku të deklarojë se do të kryej shërbimin referuar Relacionit dhe Specifikimeve Teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, si dhe do të dezinfektojë kontenierët dhe vendin përreth tyre sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponibilitet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK. Gjithashtu deklarata që OE të deklarojë se stafi i punonjësve prej 20 persona që do të paraqesë/deklarojë për kryerjen e këtij shërbimi objekt kontrate nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet e perdritshme në terren (për të gjithë periudhën e kontratës) vetëm për realizimi e këtij objekti, është kërkuar pasi ky staf ka dalë nga analizat që AK ka bërë për çdo zë pune si dhe ky staf është i domosdoshëm për realizimin e kësaj kontrate me sukses. Pastrimi i qytetit është shërbim i cili realizohet çdo ditë (7 dite në javë), prandaj është i domosdoshëm stafi i kërkuar.

2.4.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme ISO për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit si më poshtë:

- ISO/SSH/UNI 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë ose European Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- ISO/SSH/UNI 14001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë ose European Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- ISO/SSH/UNI 45001:2018 (*Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë*) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë ose European Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(* Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme ISO sipas shërbimit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 44 pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vet natyrën e kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatori ekonomik të jete i certifikuar me certifikatat ISO/SSH/UNI të kërkuara. Këto certifikate lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

- Për ISO/SSH/UNI 9001 – 2015 ose ekuivalente; Kjo certifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse

Bashkia Kurbin si Autoritet Kontraktor kërkon që shërbimet që do të kyhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO/SSH/UNI 14001 – 2015: ose ekuivalente Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015 , standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit dhe fokusohet në tre fusha kryesore: - Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë, - Standardet Operative - që masin harxhimin e burimeve natyrore dhe energjisë në proceset operative të kompanisë, dhe - Standardet e Sistemit të Mjedisit - që masin ndotjet e ndryshme nga mbetjet. Bashkia Kurbin si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- Për ISO/SSH/UNI 45001 – 2018 ose ekuivalente: Ky standart përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikën, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare.

Shënim: Ne zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.....etj. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.....”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t’i dergojë kërkesë në rrugë elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit

te kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese/mbështetëse për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëjshuara me origjinalin.

- Mosparaqitja e dokumentacionit do të jete kusht s'kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar sipas shkresës Nr.3813 Prot, datë 16.07.2026 “*Dërgim dokumentacioni tekniko-ligjor për procedurën e prokurimit me objekt: “Pastrimi, grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane dhe të ngurta, Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe e varrezave për Njësintë Administrative Milot dhe Fushë Kuqe*” (hartuar nga grupi i punës ngritur me Urdhër të Kryetarit Nr.248, datë 05.12.2025). Gjithashtu grupi i punës referuar preventivit dhe analizave ka përcaktuar edhe fondin limit për këtë procedurë.

Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e kësaj procedure, Njësia e Prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurimin.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT:

- | | |
|------------------|------------------------------|
| 1. Pjeter Bushi | Kryetar (Përsoni përgjegjës) |
| 2. Altin Marashi | Anëtar |
| 3. Rudolf Toma | Anëtar |